



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 214/ prot.

Pogradec, më 30. 01/2023

VENDIM

Nr. 12, DATË 26/01/2023

PËR

MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE MARRËVESHJES MIDIS BASHKISË POGRADEC DHE SUBJEKTEVE TË INTERESUARA PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË EFICIENCËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE NËPËRMJET VENDOSJES SË PANELEVE FOTOVOLTAIKE NË TARRACAT/ÇATITË E OBJEKTEVE PUBLIKE NË PRONËSI TË BASHKISË.

Bazuar ne nenin 35 pika 5.b, neni 22/2, neni 54 germa e te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", Kodi Civil, Ligji 8743 dt. 22.02.2001 "Per pronat e paluajtshme te shtetit", I ndryshuar, neni 12, Ligjit 8744, dt. 22.02.2001 "Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore", te ndryshuar, Ligji nr. 124/2015 "Për eficiencën e energjisë" Ligji nr. 116/2016, "Për eficiencën e energjisë në ndërtesa", Ligji nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", VKM nr. Nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030",

VENDOSI

1. Te miratoje procedurën për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme nëpërmjet paneleve fotovoltaike në mbulesat (tarraca/çati) të godinave publike në pronësi të Bashkisë Pogradec duke ndjekur hapat më poshtë:
 - 1.1. Kryetari i Bashkisë ngre grupin teknik të ekspertëve për evidentimin dhe analizimin e të dhënave teknike të godinave publike në pronësi të Bashkisë të cilat mund të shfrytëzohen për rikuperim energjie diellore nëpërmjet vendosjes së fotovoltaikëve në mbulesat e tyre. Ne grupin teknik duhet të jetë të paktën 1 (një) specialist i energjisë dhe rekomandohen specialistë të mjedisit, të pasurive të paluajtshme, inxhinierë, arkitekte etj.
 - 1.2. Grupi teknik me iniciativë dhe/ose me kërkesë nga subjektet e interesuara evidenton objektet dhe fillon punën për analizimin e të dhënave teknike mbi mundësinë e vendosjes së sistemeve fotovoltaike në mbulesat e godinave specifike. Grupi teknik duhet të analizojë por jo të kufizohet:
 - 1.2.1. Konsumi mujor i energjisë së insitucionit që zhvillon aktivitetin në godinën respektive. (fuqia e instaluar).
 - 1.2.2. Sipërfaqja mbulesë (tarracë/çati) në dispozicion të godinës për tu përdorur për



- vendosjen e fotovoltaikeve.
- 1.2.3. Masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për përshtatjen e godinës dhe vënien në funksionim të fotovoltaikeve.
 - 1.2.4. Vlerësimi i përafërt i vlerës së nevojshme për financim.
 - 1.2.5. Analiza e efektshmërisë midis investimit të nevojshëm dhe përfitimeve.
 - 1.2.6. Sasia e përafërt e sipërfaqes së nevojshme dhe pjesës tjetër e cila mbetet për vendosjen e fotovoltaikeve për përmbushjen e nevojave të insitucionit/eve që zhvillon/jnë aktivitet në godinë.
 - 1.2.7. Masa të propozuara për reduktimin e kostos së energjisë elektrike në godinë.
 - 1.2.8. Të dhëna të tjera teknike të cilat shihen të nevojshme nga grupi teknik.
- 1.3. Të dhënat teknike të pasqyruara në relacion i dorëzohen Kryetarit të Bashkisë së bashku me vlerësimin e grupit për të ndërtuar sistem fotovoltaike në mbulesën e godinës pulike si dhe me vlerësimin mbi një ofertë, nëse ka një të tillë, nga subjektet private duke evidentuar qartë:
- 1.3.1. Përfitimin e përafërt në vlerë/sasi energjie për insitucionin.
 - 1.3.2. Përfitimin në % të sasisë së energjisë vjetore të konsumuar nga insitucioni.
 - 1.3.3. Në rast të zënies së pjesëshme të mbulesës së godinës publike përcaktohet se sa përqind e mbulesës është e nevojshme për mbulimin 100% të kostove për energji të insitucionit i cili ndodhet në godinë.
- 1.4. Kryetari i Bashkisë, duke u bazuar dhe vlerësuar analizën teknike të grupit vendos:
- 1.4.1. Investimin për paisjen me sistem fotovoltaike të ndërtesës publike duke parashikuar në buxhetim vlerën e nevojshme.
 - 1.4.2. Në rast të pamundësisë së financimit ose për efikasitet ekonomik, vendos për vënien në dispozicion të mbulesës së godinës publike për subjektet private të interesuara të financojnë në ngritjen e sistemeve fotovoltaike në mbulesat e këtyre godinave duke vendosur sisteme të ndara për interesin dhe nevojat e subjekteve private por edhe sistem të ndarë për nevojat dhe konsumin e insitucionit/eve publik që zhvillon/jne aktivitet në godinë.
- 1.5. Grupi teknik ndjek zbatimin e vendimit të Kryetarit të Bashkisë në të dyja rastet.
- 1.6. Në rast se ka një interesim nga subjektet private për këto raste grupi teknik kërkon raport teknik mbi ofertën e subjektit të interesuar dhe i propozon Kryetarit të Bashkisë për të lidhur marrëveshje me palën e interesuar nëse kjo marrëveshje është në interes të Bashkisë.
- 1.7. Këshilli autorizon Kryetarin e Bashkisë të nënshkruajë marrëveshjen sipas modelit bashkangjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, dhe anëtarët e grupit teknik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi:
 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotirag MANGËRI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. _____ Prot.

Datë _____ / _____ /2023

SUBJEKTI

Nr. _____ Prot.

Datë _____ / _____ /2023

MARREVESHJE KUADËR

"Për realizimin e projekteve të eficiencës së energjisë elektrike nëpërmjet vendosjes së paneleve fotovoltaike në tarracat/çatitë e objekteve publike në pronësi të Bashkisë"

PALET

Bashkia Pogradec, përfaqësuar nga kryetari z Ilir XHAKOLLI, më poshtë I cilësuar si "**Bashkia**"

Subjekti " _____", identifikuar me NIPT _____, me seli ne _____, adresën _____, më poshtë I cilësuar si "**Financuesi**".

NENI 1

Qëllimi

- 1.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi midis Bashkisë Pogradec dhe financuesit për të vënë në shfrytëzim mbulesën (tarracë/çatinë) e ndërtesës publike në pronësi të Bashkisë Pogradec për vendosjen e paneleve fotovoltaike për përfitimin e energjisë elektrike të rinovueshme diellore në shërbim të nevojave të të dyja palëve.
- 1.2 Palët pas realizimit të studimit të mundësive teknike dhe objektive dakortësojnë që në kushtet e cilësuar në këtë kontratë të shfrytëzojnë mbulesën e godinës publike për vendosjen e paneleve fotovoltaike me qëllim rikuperimin e energjisë elektrike. Ky financim do të përballohet nga financuesi, duke ndarë energjinë e përfituar sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje.
- 1.3 Për realizimin e këtij projekti të përbashkët, Bashkia Pogradec ve në dispozicion për përdorim 30 (tridhjet) vjekar me të drejtë ripërtëritjeje për të njëjtin qëllim edhe mbulesën (tarracë/çatinë) e ndërtesës publike në pronësi të Bashkisë me nr. Pasurie, Nr. _____, me sip. _____ m², ZK _____, sipas skicës bashkangjitur kësaj marrëveshjeje.
- 1.4 Realizimi i projektit nëpërmjet vendosjes së paneleve fotovoltaike në mbulesën e ndërtesës publike, në asnjë mënyrë nuk mund të pengojë apo ndikojë aktivitetin e institucionit publik apo të ndërhyjë ose ndryshojë funksionalitetin e cdo pjese të



godinës publike. Në këtë kuptim, realizimi i projektit nuk duhet të sjellë dëmtim të mbulesës ose të krijojë probleme në katet e mëposhtëme. Çdo anomali që do vijë duhet të korrigojë nga financuesi me kostot e tij.

- 1.5 Procedura për nenshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjes realizohet në përputhje me parimet e ruajtjes dhe garantimit të interesit publik, si dhe ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të pronës së Bashkisë Pogradec.

NENI 2

OBJEKTI

- 2.1. Objekti i kësaj marrëveshjeje është vënia në dispozicion dhe në eficiencë e mbulesave (tarraca/çati) të objekteve publike në pronësi të Bashkisë Pogradec për vendosjen e paneleve fotovoltaike për rikuperimin e energjisë diellore.
- 2.2. Palët për të arritur qëllimin marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet të sanksionuara në këtë marrëveshje, duke bashkëpunuar me mirëbesim dhe në përputhje të plotë me legjislacionin pa dëmtuar interesat apo qëllimet e njëri tjetrit.
- 2.3. Çdo ndryshim destinacioni, përpara ose pas afatit të përdorimit 30 (tridhjet) vjecar, bën që kjo marrëveshje të prishet dhe secila palë të kërkojë nga pala tjetër të gjitha të drejtat e munguara dhe sanksionuara në nenin 8.3.
- 2.4. Financuesi, në bazë të analizës teknike bashkangjitur, vendos dhe monton panelet, paisjet e nevojshme dhe rrjetin, siguron vënien në funksion të gjithë sistemit duke i ndarë në dy sisteme të ndara si dhe siguron mirëmbajtjen periodike të të dy sistemeve:
- 2.4.1. Sistemi i cili do jetë në përdorim dhe pronësi të insitucionit publik (Bashkisë Pogradec) me të dhënat:
- 2.4.1.1. Fuqia e Instaluar _____
- 2.4.1.2. Panele fotovoltaike: _____
- 2.4.1.3.
- 2.4.2. Sistemi i cili do jetë në përdorim dhe pronësi të subjektit financues me të dhënat:
- 2.4.2.1. Fuqia e Instaluar _____
- 2.4.2.2. Panele fotovoltaike: _____
- 2.4.2.3.

NENI 3

BAZA LIGJORE

- 3.1. Ligji nr. 139/2015 "Për veteqeverisjen vendore".
- 3.2. Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.
- 3.3. Ligji nr. 8743 dt. 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar.
- 3.4. Ligji nr. 8744, dt. 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore".
- 3.5. Ligji nr. 124/2015 "Për eficiencën e energjisë".
- 3.6. Ligji nr. 116/2016, "Për eficiencën e energjisë në ndërtesa".
- 3.7. Ligji nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".
- 3.8. VKM nr. Nr. 480, datë 31.7.2018, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030".



NENI 4

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE


4.1. Bashkia Pogradec ka të drejta dhe detyrime si më poshtë:

- 4.1.1. Bashkia Pogradec merr përsipër të verë në dispozicion të subjektit financues, të dhënat, planimetritë, dhe fizikisht për verifikim dhe realizimin e vendosjes së paneleve fotovoltaike në mbulesën e insitucionit _____, në pronësi të saj të dhëna të cilat janë të nevojshme për të analizuar mundësitë dhe më pas të për të zbatuar projektin e vendosjes së paneleve fotovoltaike.
- 4.1.2. Të jape garanci dhe ta mbroje sendin nga shqetesimet e te treteve;
- 4.1.3. Bashkia Pogradec merr përsipër plotësimin e procedurës për marrjen e të drejtës nga OSHEE, apo cdo institucion tjetër për të bërë të mundur lidhjen e kontratës së frunizimit të energjisë elektrike për institucionin publik me të drejtat që i jep ligji konsumatorit të energjisë dhe prodhuesit të energjisë elektrike më fotovoltaike. Bashkia në cdo rast ka të drejtën të reduktojë/zerojë konsumin e energjisë elektrike për insitucionin i cili ka në përdorim godinën objekt marrëveshjeje. Analiza paraprake e realizuar nga ekspertet ka detajet e llogaritjeve të reduktimit/zerimit të konsumit të energjisë.
- 4.1.4. Bashkia merr përsipër të aplikojë për cdo lejë/autorizim/miratim nga institucionet publike të nevojshme për vendosjen dhe vënien në funksionim të sistemit fotovoltaike, vetëm për pjesën e cila do i shërbejë insitucionit publik të përcaktuar në pikën 2.4.1., të kësaj marrëveshjeje. Për këtë qëllim bashkia merr nga subjekti financues projektin teknik të sistemit që do të vendoset prej tij në mbulesën e objektit publik.
- 4.1.5. Bashkia Pogradec, bëhet pronare e sistemit të përcaktuar në pikën 2.4.1., të kësaj marrëveshjeje.
- 4.1.6. Bashkia Pogradec, është e detyruar të përcaktojë një person përgjegjës për të monitoruar këtë kontratë dhe për të shërbyer si person përgjegjës për bashkëpunimin me subjektin financues në cilësinë e përfaqësuesit të saj. Ky person do të sigurojë mbarëvajtjen e punës për realizimin e projektit, do të kontaktojë dhe kërkojë zgjidhje me subjektin financues për cdo problem që do dalë gjatë zbatimit por edhe për gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje.
- 4.1.7. Njofton furnizuesin e pasijeve si mbajtësi i garancisë minimalisht 10 vjecarë nëpërmjet personit përgjegjës për cdo defekt, mosfunksionim të sistemit të paneleve fotovoltaike dhe ndjek riparimin dhe vënien në funksionim të sistemit. Financuesi dorëzon dokumentat e mallit për sistemin në dispozicion dhe pronësi të bashkësië ku cilësohet vlera, furnizuesi, garancia etj. Për cdo problem në vijim, personi përgjegjës informon dhe Bashkinë dhe kërkon zgjidhjen sipas natyrës së problemit.
- 4.1.8. Njofton subjektin financues, nëpërmejt personit përgjegjës, për cdo dëmtim që mund ti shkaktohet objektit publik gjatë vendosjes së sistemit ose në vazhdimësi gjatë funksionimit dhe ndjek riparimin e defekteve. Njëkohësisht njofton subjektin edhe për cdo lloja shqetësimi që mund të vijë në objekt apo në aktivitetin normal të insitucionit publik nga vënia apo funksionimi jo normal i sistemit fotovoltaike.
- 4.1.9. Bashkia ngre grupin e punës për marrjen në dorëzim të pjesës së sistemit të ngritur për të (përcaktuar në pikën 2.4.1.)

4.2. Subjekti Financues ka të drejta dhe detyrime si më poshtë:



- 4.2.1. Subjekti financues në cilësinë e zhvilluesit do të përgatise dhe vendose në dispozicion të Bashkisë Pogradec projektin e sistemit të cilin do realizojë në baze të analizës teknike bashkangjitur si dhe do aplikojë për çdo leje/miratim/konfirmim në institucionet përgjegjëse të përcaktuara nga ligji për sistemin në përdorim dhe pronësi të tij të përcaktuar në pikën 2.4.2., të kësaj marrëveshjeje. Projekti teknik duhet të përmbajë por pa u kufizuar dokumentat e mëposhtme:
 - 4.2.1.1. Dokumentacionin e nevojshëm për tu paraqitur në organet përkatëse dhe të kerkuara nga Bashkia Pogradec, me shpenzimet e veta.
 - 4.2.1.2. Do të realizojë dhe do të perfundojë punimet sipas projektit të miratuar dhe brenda afateve të përcaktuara në lejet përkatëse
 - 4.2.1.3. Do të regjistrojë të drejtën e përdorimit të mbulesës, vetëm për sipërfaqen e nevojshme për sistemin në përdorim dhe në pronësi të tij të përcaktuar në pikën 2.4.2., të marrëveshjes por pa ndryshuar pronësinë e objektit dhe të kateve në pronësi të Bashkisë Pogradec. Kopje e shënimit duhet të dorëzohet në Bashkisë Pogradec.
- 4.2.2. Subjekti financues, do blejë, vendosë montojë dhe verë në funksionim të plotë të dyja sistemet fotovoltaike të pavarura nga njëri tjetri edhe atë në përdorim dhe pronësi të Bashkisë (të përcaktuar në pikën 2.4.1., edhe atë në përdorim dhe pronësi të subjektit financues (të përcaktuar në pikën 2.4.2.
- 4.2.3. Gjatë zbatimit të projektit si dhe gjatë gjithë funksionimit të tij, subjekti financues merr përsipër:
 - 4.2.3.1. Mirëmbajtjen normale (pastrime, bora etj) e sistemit fotovoltaike në përdorim dhe pronësi të Bashkisë Pogradec të përcaktuar në pikën 2.4.1.
 - 4.2.3.2. Mirëmbajtjen e mbulesës (tarracë/çati) të objektit në pronësi të Bashkisë Pogradec për të mos sjellë pasoja në katet e mëposhtme të godinës.
 - 4.2.3.3. Të mos sjellë asnjë shqetësim në objekt apo aktivitetin normal të punës të institucionit i cili ndodhet në godinën publike objekt marrëveshjeje.
 - 4.2.3.4. Për çdo shqetësim, nevojë për të aksesuar sistemet fotovoltaike, apo nevojë për ndërhyrje tjetër duhet të komunikojë dhe njoftojë personin përgjegjës së marrëveshjes së përcaktuar nga Bashkia sipas pikës 4.1.6.
- 4.2.4. Nëse Subjekti financues kërkon të transferojë të drejtat dhe detyrimet e sistemit në pronësi dhe përdorim të tij të përcaktuara në pikën 2.4.2., të njëjtit, nuk mund të bëjë transferimin pa marrë me parë miratimin me shkrim të Bashkisë Pogradec. Në çdo rast transferimi i këtyre të drejtave dhe detyrimeve do të bëhet në bashkëpunim me transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të marra përsipër në këtë marrëveshjeje.
- 4.2.5. Subjekti financues detyrohet dhe është personi përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës, politikën e sigurimeve dhe të drejtave të punonjësve që duhet të ndiqen, nga prej tij, gjatë zbatimit të punimeve dhe gjithë kohezgjatjes së kësaj marrëveshjeje.
- 4.2.6. Çdo taksë apo tarifë që rrjedh si pasojë e marrëveshjes midis Bashkisë Pogradec dhe subjektit financues është në ngarkim të këtij të fundit, me përjashtim të tarifës së pajisjes me dokumentin e pronësive në emër të Bashkisë Pogradec.
- 4.2.7. Të angazhohet maksimalisht duke bashkëpunuar me Bashkinë për të realizuar projektin, objekt të kësaj marrëveshjeje të cilësuar në nenin 2.
- 4.2.8. Çdo aksesim në objekt dhe në mbulesën e objektit do të kryhet vetëm vetëm për realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshjeje.



NENI 5
FORCA MADHORE

- 5.1. Per qellimet e ketij neni "Force Madhore" do te thote nje ngjarje jashte kontrollit te paleve mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshmerine nga ana e tyre. Ngjarje te tilla mund te perfshijne, lufta ose revolucionet, zjarri, permbytja, termeti, epidemite, etj.
- 5.2. Palet perjashtohen nga detyrimet e ndesjellta ne rast se mosekzekutimi i kesaj kontrate ndodh per shkak te Forces Madhore.

NENI 6
SANKSIONET


- 6.1. Ne rast mosekzekutimi të detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje per faj te njëres palë, pala tjetër ka te drejte te kërkojë përmbushjen në natyrë të detyrimit, dhe nëse kjo nuk është e mundur, mund të kërkojnë shpërblim demi i cili i korespondon vleres se sendit qe debitori shkemben duke perfshire dhe fitimin e munguar. Fitimi I munguar në rast ndërprerje të funksionimit të sistemit fotovoltaik është vlera e energjisë elektrike e cila do të prodhohej gjatë periudhës kur ka ekzistuar mospërmbushja e detyrimit.
- 6.2. Cdo devijim nga qëllimi I kësaj kontrates e I jep të drejtën Bashkisë të prishë kontratën dhe të kërkojë lirim të pronës së saj nga cdo objekt I vendosur mbi të.

NENI 7
AFATET

- 7.1. Data e hyrjes ne fuqi e marreveshjes do te jete data e nenshkrimit te saj dhe shtrin efektet deri ne përfundim të projektit.
- 7.2. Pas përmbushjes së afatit 30 (tridhjet) vjecar për të drejtën e përdorimit të pjesës së mbulesës së objektit public (pjesa e nevojshme për vendosjen e fotovoltaikëve), palët mund të dakortësojnë vazhdimin e marrëdhënies së tyre. Rinovimi në heshtje është I vlefshëm.

NENI 8
ZGJIDHJA E MARREVESHJES

- 8.1. Marrevëshja zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në të.
- 8.2. Marrevëshja mund te zgjidhet para afatit:
 - 8.2.1. Me pëlqim midis paleve.
 - 8.2.2. Kur prona humbet teresisht ose demtohet per shkak te nje force madhore.
- 8.3. Në rast të prishjes së njëanëshme të marrëveshjes para afatit, secila palë I detyrohet palës tjetër shpërblimin e vlerës së sistemit që përdor/ka në pronësi pala që nuk prish kontratën si dhe fitimin e munguar I cili përbëhet nga vlera e energjisë elektrike që sistemi do të prodhonte deri në përfundim të afatit. Ky vlerësim është rezultat I llogaritjes mesatare të prodhimit mujor të prodhuar deri në momentin e prishjes së kontratës shumëzuar me muajt e mbetur deri në përfundim të kontratës.



Neni 9

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE.

- 9.1. Per mosmarreveshjet e ndryshme qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj marreveshje, palet zotohen t'i zgjidhin me mirekuptim, ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Pogradec dhe/ose Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe.
- 9.2. Ne rast mosekzekutimi te marreveshjes apo shkeljeve te kryera nga palet, ato detyrohen ne menyre te ndersjellte te njoftojne njera-tjetren me shkrim per shkeljet e konstatuara, duke vendosur nje afat 1 javor per rregullimin e tyre.
- 9.3. Ne rast mosperbushjes se detyrimeve te parashikuara ne marreveshje, ne menyre te perseritur, ndaj paleve do te aplikohen sanksionet e parashikuara ne legjislacionin ne fuqi, Kodin Civil i cili rregullon marredhenien juridike mes paleve kontraktore dhe çdo rregullim ligjor i aplikueshem ne kete rast.

Neni 10

DISPOZITA TË FUNDIT

- 10.1. Për shkak se marrëveshja parashikon dhënien e një të drejtë reale mbi pasurinë e paluajtshme (e drejta e përdorimit të një pjese të godinës), marrëveshja do të nënshkruhet përpara noterit dhe do regjistrohet në regjistrat e pronave të paluajtshme sipas dispozitave ligjore.
- 10.2. Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe në 2 (dy) kopje, nga një për secilën palë.
- 10.3. Pasi u lexua, kuptua dhe dakortësua nga palët firmoset rregullisht prej tyre.

Bashkia Pogradec

Kryetari

Ilir XHAKOLLI

Për subjektin financues

Administratori

(_____)

